



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 5.5.2023

Nr: 444

Ora: 12:30

VENDIM

PËR

**DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES SË DISA QENDRAVE TË VOTIMIT,
PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 62, pika 4, nenit 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve, përveç rasteve kur për shkak të forcave madhore, ndryshimi autorizohet nga KQZ-ja, sipas përcaktimit të nenit 62, pika 4, të Kodit Zgjedhor.

Pranë KQZ janë administruar kërkesat nga kryetarët e disa bashkive, për ndryshimet e disa qendrave të votimit, duke marrë shkas nga verifikimi dhe raportimi i kryer nga Policia e Shtetit në terren për kushtet e qendrave të votimit, konkretisht:

Bashkia Durrës

- me shkresën nr. 4522 prot., datë 03.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1344/00, QV nr. 1345/00 nga ambienti publik i shkollës 9-vjeçare “Riza Shera”, në ambientin privat të z. Dylaver Hushi. Arsytimi i Bashkisë për ndryshimin e qendrës së votimit është përfshirja e shkollës në programin e rikonstruksionit për shkak të dëmit të kategorisë DS4.
- me shkresën nr. 4523 prot., datë 03.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 1526/00, QV nr. 1526/01 nga ambienti publik Shkolla e Bashkuar, Katund i Ri, në ambientin publik Qendra Shëndetësore Katund i Ri. Arsytimi i Bashkisë për ndryshimin

Data: 5.5.2023 Nr: 444
Ora: 12:30



“Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

e qendrës së votimit është përfshirja e shkollës në programin e rikonstruksionit për shkak të dëmit të kategorisë DS4.

Bashkia Kamëz

- me shkresën nr. 4274 prot., datë 27.04.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 2040/02, QV nr. 2040/03 nga ambienti privat Sefedin Ahmati dhe Hasim Ahmati (miratuar me vendimin nr. 230, datë 31.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve), në ambientin privat të z. Sadrazem Çerpia. Arsytimi i Bashkisë për ndryshimin e dy qendrave të votimit është në kushtet e konfliktit të interesit, pasi njëri nga pronarët z. Sefedin Ahmati është shpallur kandidat i një prej subjekteve politike, në listat e këshillit bashkiak.

Bashkia Gjirokastrë

- me shkresën nr. 4532 prot., datë 03.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 4265/00, nga ambienti publik Qendra Kulturore në Shkollën 9-vjeçare po në fshatin Asim Zeneli, me arsyetimin që është një ambient i papërshtatshëm dhe i parregullt. Ndryshimin e QV nr. 4241 nga ambienti publik shkolla “Bajo Topulli”, në Qendrën Shëndetësore Dunavat, me arsyetimin se në ekstraktin e gjendjes civile vijon të referohet shkolla “Bajo Topulli”, ku ndërkohë kjo shkollë është e rrënuar.

Bashkia Selenicë

- me shkresën nr. 4436 prot., datë 02.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 4528/00, QV nr. 4528/01 nga ambienti publik Shkolla e Mesme “Hajredin Beqari”, në ambientin publik Kopështi i Fëmijëve Selenicë. Arsytimi i Bashkisë për ndryshimin e dy qendrave të votimit është mospërfundimi në afat i rikonstruksionit të Shkollës e Mesme “Hajredin Beqari”.

Bashkia Korçë

- me shkresën nr. 4548 prot., datë 03.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 3736/00, nga ambienti publik shkollë 9-vjeçare në ambientin privat të z. Iriat Ravolli, me arsyetimin që është e dëmtuar dhe pa kushte. Ndryshimin e QV nr. 3736/01 nga ambienti publik shkollë 9-vjeçare, në ambientin privat të z. Stavri Ravolli.

Bashkia Finiq

- me shkresën nr. 4547 prot., datë 03.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 4683/00, nga ambienti publik Institucion Arsimor Shkollë, në ambientin publik Qendër Shëndetësore fshati Aliko (50 m nga shkolla), me arsyetimin se shkolla është e dëmtuar dhe është në fazë rikonstruksioni.

Bashkia Divjakë

- me shkresën nr. 4443 prot., datë 02.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 2980/00 fshati Karavasta, nga ambienti publik Institucion Arsimor Shkollë, në ambientin e Kopshtit, me arsyetimin se shkolla nuk është funksionale (pa dritare dhe dyer). Ndryshimin e QV nr. 2982/00 fshati Adriatik, nga ambienti publik Shkollë në ambientin publik Ambulancë, me arsyetimin se shkolla nuk është funksionale (pa dritare dhe dyer).

Bashkia Kuçovë

- me shkresën nr. 4435 prot., datë 02.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 3512/00, nga ambienti publik Kopësht, në ambientin privat të z. Spiro Tavani, me arsyetimin që nga kontrolli i fundit i kryer në këtë ambient, reshjet e shiut e kanë dëmtuar dhe është bërë i papërshtatshëm për të shërbyer për qendër votimi.

Bashkia Skrapar

- me shkresën nr. 4648 prot., datë 04.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr.3593/00, nga ambienti publik shkollë të fshatit Zogas, në shkollë të fshatit Çerenisht, me arsyetimin që shkolla e fshatit Zogas është e rrënuar.

Bashkia Mallakastër

- me shkresën nr. 4546 prot., datë 03.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 3232/00, nga ambienti publik shkolla 9-vjeçare “Gjokë Doçi”, në ambientin publik shkollën e mesme të përgjithshme “Hajredin Fratari”, me arsyetimin që është e dëmtuar nga tërmeti dhe nuk është funksionale.

Kryetarët e bashkive kanë depozituar dokumentacionin përkatës për propozimet për ndryshimet e qendrave të votimit.

Bashkia Shkodër

- me shkresën nr. 4630 prot., datë 03.05.2023, ka kërkuar ndryshimin e vendndodhjes së QV nr. 0236/00, QV nr. 0236/01 nga ambienti publik Shkolla 9-vjecare Shirokë, në ambientin publik Qendra Shëndetësore Shirokë, me arsyetimin se shkolla nuk ka aksesueshmëri dhe kriteret e ligjit. Ndryshimin e QV nr. 0336/00 nga Qendra shëndetësore në shkollën 9-vjecare “Tonç Gjon Toma”, dhe ndryshimin e QV nr. 0341 nga Qendra shëndetësore në shkollën 9-vjecare “Zef Jubani”, me arsyetimin se të dyja qendrat shëndetësore janë të mbushura me pajisje mjeksore si dhe janë ambiente tejet të ngushta.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 62, pika 4, nenin 93, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kryetarët e bashkive të afishojnë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, të caktuara me këtë vendim.
3. Kryetarët e bashkive të rinjoftojnë menjëherë zgjedhësit, për adresën e re të qendrave të votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Lidhja 1

Qarku	Bashkia	Nr.	Njësia Adm	QV	Vendndodhja QV
Durrës	Durrës	1	Manëz	1344/00	Ambient shërbimi Dylaver Hushi
		2	Manëz	1345/00	Ambient shërbimi Dylaver Hushi
		3	Katund i Ri	1526/00	Qendra Shëndetësore Katund i Ri
		4	Katund i Ri	1526/01	Qendra Shëndetësore Katund i Ri
Tiranë	Kamëz	5	Paskuqan	2040/02	Ambient shërbimi Sadrazem Çerpia
		6	Paskuqan	2040/03	Ambient shërbimi Sadrazem Çerpia
Gjirokastrë	Gjirokastrë	7	Gjirokastrë	4265/00	Fshati Asim Zeneli, institucion arsimor Shkolla 9-vjeçare
		8	Gjirokastrë	4241/00	Qendra Shëndetësore, Dunavat
Vlorë	Selenicë	9	Selenicë	4528/00	Kopështi i fëmijëve, Selenicë
		10	Selenicë	4528/01	Kopështi i fëmijëve, Selenicë
	Finiq	11	Aliko	4683/00	Fshati Aliko, Qendër Shëndetësore
Korçë	Korçë	12	Korçë	3736/00	Ambient shërbimi Iriat Ravolli
		13	Korçë	3736/01	Ambient shërbimi Stavri Ravolli
Fier	Divjakë	14	Remas	2980/00	Fshati Karavasta, Kopështi i fëmijëve
		15	Remas	2982/00	Fshati Adriatik, Ambulancë
	Mallakastër	16	Fratari	3232/00	Shkolla e Mesme e Përgjithshme "Hajredin Fratari"
Berat	Kuçovë	17	Perondi	3512/00	Ambient shërbimi Spiro Tavani
	Skrapar	18	Qendër	3593/00	Shkollë në fshatin Çerenisht
Shkodër	Shkodër	19	Gur i Zi	0336/00	Shkolla 9-vjeçare "Tonç Gjon Toma"
		20	Gur i Zi	0341/00	Shkolla 9-vjeçare "Zef Jubani"
		21	Shirokë	0236/00	Qendër Shëndetësore Shirokë
		22	Shirokë	0236/01	Qendër Shëndetësore Shirokë